URDHËR
Nr. 182, datë 20.3.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë"; të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për datën 21.3.2025, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja